

L I G J
Nr.8026, datë 9.11.1995

PËR PRIVATIZIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE QË VEPROJNË NË SEKTORIN MINERAR

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Lejohet privatizimi i kapitalit shtetëror në shoqëritë tregtare që veprojnë në sektorin minerar në kërkimin, shfrytëzimin dhe përpunimin e mineraleve etj., që përfshihen në ligjin “minerar” nr.7796, datë 17.2.1994.

Neni 2

Për efekt të këtij ligji, shoqëritë që veprojnë në sektorin minerar klasifikohen në të mëdha, të mesme dhe të vogla nga Këshilli i Ministrave.

Neni 3

Shitja e kapitalit të shoqërive tregtare bëhet me shitjen direkte të aksioneve të këtyre shoqërive ose me shitje të pjesëve të veçanta të këtyre shoqërive.

Neni 4

Forma e privatizimit do të jetë si më poshtë:

a) Privatizimi i shoqërive të mëdha bëhet me investitorë strategjikë (shoqëri të afirmuara në fushën përkatëse dhe që zotërojnë kapitalin e nevojshëm), të cilët duhet të zotërojnë jo më pak se 30 për qind të aksioneve, kurse jo më pak se 20 për qind të aksioneve të shiten sipas PPM.

b) Privatizimi i shoqërive të mesme bëhet me shoqëri anonime, me investitorë strategjikë ose jostrategjikë (shoqëri që kanë kapitalin e nevojshëm), të cilët do të zotërojnë jo më pak se 30 për qind, ndërsa jo më pak se 30 për qind e aksioneve do të shiten sipas PPM.

c) Privatizimi i shoqërive të vogla bëhet me shoqëri anonime ose me përgjegjësi të kufizuar, duke i dhënë përparësi bonove të privatizimit.

Procedurat, mënyrat dhe koha e privatizimit do të përcaktohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e Ministrisë së Burimeve Minerare dhe Energjetike.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1294, datë 21.11.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha